

**REZOLUTË 63/156 MBI TRAFIKIMIN E GRAVE DHE VAJZAVE  
e adoptuar nga Asambleja e Përgjithëshme**

*[mbi raportin e Komitetit të Tretë (A/63/425)]*

*Asambleja e Përgjithëshme,*

*Duke sjellë në vëmendje të gjitha konventat ndërkombëtare që merren posaçërisht me problemin e trafikimit të grave dhe të vajzave, si Konventa për Zhdukjen të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave<sup>1</sup>*

*dhe Protokollin Opsional të saj<sup>2</sup> Konventën për të Drejtat e Fëmijës<sup>3</sup> dhe Protokollin Opsional të tij për shitjen e fëmijëve, prostitucionin fëmënor dhe pornografinë fëmënore<sup>4</sup>, Konventa për Shtypjen e Trafikimit të Njerëzve dhe për Shfrytëzimin e Prostitucionit të të tjerëve<sup>5</sup> dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional<sup>6</sup> dhe Protokollet e tyre, në veçanti Protokollin për Parandalimin e Shtypjes dhe Ndëshkimi i Trafikimit të Njerëzve, veçanërisht Grave dhe Fëmijëve, që janë suplemente të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional<sup>7</sup>*

*dhe Protokollin kundër Kontrabandimit të Migrantëve nga Toka, Deti dhe Ajri, përfshirë e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional<sup>8</sup> si dhe rezolutat e mëparshme të Asamblesë së Përgjithëshme dhe organit të tij vartës Këshilli për Të Drejtat e Njeriut*

*dhe Këshilli Ekonomik dhe Social dhe komisionet e veta funksionale për këtë çështje,*

*Duke riafirmuar dispozitat që lidhen me trafikimin e grave dhe të vajzave që gjenden në dokumentet që kanë dalë nga konferencat dhe samitet përkatëse ndërkombëtare, në veçanti objektivi strategjik për çështjen e trafikimit që përmbahet në Deklaratën e Beijing dhe në Platformën e Veprimi të adoptuar nga Konferenca e Katërt Botërore për Gratë<sup>9</sup>*

*Duke riafirmuar gjithashtu angazhimin e bërë nga udhëheqësit botërorë në*

---

<sup>1</sup> Kombet e Bashkuara, Seria e Traktateve, Vol.1249, Nr. 20378

<sup>2</sup> Ibid., vol. 2131, No. 20378.

<sup>3</sup> Ibid., vol. 1577, No. 27531.

<sup>4</sup> Ibid., vol. 2171, No. 27531.

<sup>5</sup> Ibid., vol. 96, No. 1342.

<sup>6</sup> Ibid., vol. 2225, No. 39574.

<sup>7</sup> Ibid., vol. 2237, No. 39574.

<sup>8</sup> Ibid., vol. 2241, No. 39574.

<sup>9</sup> Raporti i Konferencës së Katërt Botërore për Gratë, Beijing, 4–15 shtator 1995 (Publikim i Kombeve të Bashkuara, Shitjet Nr. E.96.IV.13), kap. I, rezolutë 1, anekset i dhe II.

Samitin e Mileniumit dhe në Samitin Botëror të 2005, për të krijuar, zbatuar dhe forcuar masat efektive për të luftuar të gjitha format e trafikimit të personave dhe për t'iu kundërvënë kërkesës për viktima të trafikut dhe për mbrojtjen e viktimave

*Duke sjellë në vëmendje* raportet e Raportuesit të Posaçëm për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve, Raportin për trafikimin e personave, në veçanti atë të grave dhe të fëmijëve, dhe Raportin e Posaçëm për dhunën kundër grave, shkaqet dhe pasojat e saj, si dhe në informacionin në lidhje me trafikimin e grave dhe të vajzave, që gjendet në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm për studimin e thelluar të të gjitha formave të dhunës kundër grave<sup>10</sup>

*Duke sjellë në vëmendje* edhe raportin e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin me titull: “Trafikimi i qenieve njerëzore: Modele Globale” e prill 2006 dhe në vëmendjen e treguar për situatën e grave dhe të vajzave të trafikuar,

*Duke pasur parasysh* Forumin e Vienës për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, të mbajtur nga 13 deri në 15 shkurt 2008, brenda kornizës së Nismës Globale për të Luftuar Trafikimin Njerëzor, dhe për debatin tematik për çështjen e trafikimit të personave, të mbajtur në 3 qershor 2008, brenda kornizës së Asamblesë së Përgjithëshme,

*Duke pasur parasysh* rifreskimin e mandatit të Raportuesit të Posaçëm për trafikimin e personave, veçanërisht të grave dhe të fëmijëve, dhe faktin që pjesë e punës së saj është integrimi i perspektivës gjinore dhe moshore në tërë punën gjatë mandatit të saj, përmes identifikimit të pikave të dobëta që lidhen me gjini dhe moshë specifike në lidhje me çështjen e trafikimit të personave,

*Duke pranuar* përfshirjen e krimeve që lidhen me gjininë në Statutin e Romës të Gjykatës Ndërkombëtare Penale<sup>11</sup> që hyri në fuqi në 1 qershor 2002,

*Duke mbajtur parasysh* se të gjitha Shtetet kanë detyrimin për të qënë vigjilent për parandalimin, hetimin dhe ndëshkimin e autorëve të trafikimit të personave dhe për të shpëtuar viktimat si dhe për t'i mbrojtur ato. Nëse nuk bëhet kjo atëherë shkelet, dhe dëmtohet gëzimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të viktimave,

*Duke qënë seriozisht të shqetësuar* që një numër në rritje grash dhe vajzash nga disa vende në zhvillim dhe vende me ekonomi në tranzicion po trafikohen në vendet e zhvilluara, si dhe brenda dhe nëpër rajone dhe shtete, dhe që burrat dhe djemtë janë viktima të trafikimit, përfshirë shfrytëzimin seksual,

*Duke pranuar* se disa përpjekje kundër trafikimit të personave nuk kanë ndjeshmëri gjinore dhe moshore të nevojshme për të trajtuar me efektshmëri situatën e grave dhe të vajzave, që janë veçanërisht të pambrojtura ndaj trafikimit për qëllime të shfrytëzimit seksual, punës së detyruar, shërbimeve dhe formave të tjera të shfrytëzimit, duke theksuar kështu nevojën për përfshirjen e perspektivës gjinore dhe moshore në të gjitha përpjekjet kundër trafikimit,

---

<sup>10</sup> A/61/122 dhe Add.1 dhe Add.1/Corr.1.

<sup>11</sup> Kombet e Bashkuara, Seria e Traktateve, vol. 2187, Nr. 38544

*Duke pranuar* edhe nevojën për të trajtuar ndikimin e globalizimit për problemin e trafikimit të grave dhe të fëmijëve, në veçanti të vajzave,

*Duke pranuar* sfidat e luftës kundër trafikimit të grave dhe vajzave për shkak të mungesës së legjislacionit të përshtatshëm dhe moszbatimit të legjislacionit ekzistues, mungesës së të dhënave dhe statistikave të besueshme, të zbërthyer sipas seksit dhe mungesën e burimeve,

*Të shqetësuar* nga përdorimi i teknologjisë së re të informacionit, përfshirë internetin, për qëllime të shfrytëzimit të prostitucionit nga të tjerët, për trafikimin e grave si bashkëshorte, për turizmin seksual të grave dhe të vajzave dhe për pornografinë feminare, pedofilinë dhe çdo formë tjetër të shfrytëzimit seksual të fëmijëve,

*Të shqetësuar* nga aktivitetet në rritje të organizatave kriminale transnacionale dhe të tjerëve që përfitojnë nga trafikimi ndërkombëtar i personave, veçanërisht i grave dhe i vajzave, pa marrë parasysh kushtet e rrezikshme dhe jo njerëzore dhe në shkelje flagrante të standardeve të ligjeve vendore dhe ndërkombëtare,

*Duke pranuar* se viktimat e trafikimit janë veçanërisht të ekspozuara ndaj racizmit, diskriminimit racial, ksenofobisë, dhe intolerancës që lidhet me to, dhe se gratë dhe vajzat janë shpesh subjekt i formave të ndryshme të diskriminimit dhe të dhunës, përfshirë për shkak të gjinisë, moshës, etnisë, kulturës, dhe fesë si dhe të origjinës së tyre, dhe se këto forma diskriminimi në vetvete mund të ushqejnë trafikimin e personave,

*Duke vërejtur* se disa nga kërkesat për prostitucion dhe punë të detyruar plotësohen përmes trafikimit të personave në disa pjesë të botës,

*Duke pranuar* se gratë dhe vajzat viktimat e trafikimit, për shkak të gjinisë së tyre, janë në kushte të disfavorshme dhe të izoluara nga mungesa e përgjithshme e informacionit apo ndërgjegjësimit, nga mosnjohja e të drejtave të tyre të njeriut, dhe shpesh nga stigma që shoqëron trafikimin, si dhe nga pengesat që ato hasin për të marrë informacion dhe se kërkohen masa të posaçme për mbrojtjen e tyre dhe për rritjen e ndërgjegjësimit të tyre,

*Duke riafirmuar* rëndësinë e mekanizmave dhe të nismave për bashkëpunimin dypalësh, nënrajonal, rajonal dhe ndërkombëtar, përfshirë shkëmbimin e informacionit për praktikatat më të mira, të qeverive, dhe organizatave ndërqeveritare dhe joqeveritare për të trajtuar problemin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe të fëmijëve,

*Duke riafirmuar* edhe që përpjekjet globale, përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar dhe programet e ndihmës teknike, për çrrënjosjen e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, kërkojnë një angazhim të fortë politik, përgjegjësi të përbashkët dhe bashkëpunim aktiv të të gjitha qeverive të vendeve të origjinës, tranzitit dhe destinacionit,

*Duke pranuar* që politikatat dhe programet për parandalimin, riaftësimin dhe ri-integrimin duhet të zhvillohen përmes trajtimit me orientim gjinor dhe moshor, të gjithëanshëm dhe shumëdisiplinësh, që merret me sigurinë e viktimave dhe respekton gëzimin e plotë të të

drejtave të njeriut me përfshirjen e të gjithë aktorëve në vendet e origjinës, tranzitit dhe destinacionit,

*Të bindur* për nevojën për të mbrojtur dhe ndihmuar të gjitha viktimat e trafikimit, në respekt të plotë për të drejtat njerëzore të viktimave,

1. *Mirëpret* përpjekjet e qeverive, organeve të Kombeve të Bashkuara dhe të agjencive dhe organizatave ndërqeveritare dhe jo-qeveritare për të trajtuar problemin e veçantë të trafikimit të grave dhe të vajzave, dhe për t'i inkurajuar ato që të forcojnë përpjekjet dhe bashkëpunimin, përfshirë shkëmbimin e dijeve, ekspertizës teknike dhe të praktikave më të mira;

2. *U bën thirrje* qeverive që të shkurajojnë, deri në zhdukje, kërkesën që mban gjallë trafikimin e grave dhe të vajzave për të gjitha format e shfrytëzimit, dhe në këtë aspekt të zgjerojnë masat parandaluese, përfshirë masat legislative, për të shkurajuar shfrytëzuesit e personave të trafikuar, si dhe për të garantuar llogaridhënien e tyre;

3. *U bën gjithashtu thirrje* qeverive që të marrin masat e përshtatshme për të trajtuar faktorët që rrisin mundësitë për t'u trafikuar, përfshirë varfërinë dhe pabarazinë gjinore, si dhe faktorë të tjerë që inkurajojnë problemin e trafikimit të grave dhe të vajzave për prostitucion dhe forma të tjera të seksit komercial, martesën e detyruar dhe punën e detyruar në mënyrë që të parandalohet dhe zhduket trafikimi, përfshirë përmes forcimit të legjislacionit ekzistues me qëllim mbrojtjen më të mirë të të drejtave të grave dhe vajzave dhe ndëshkimin e autorëve përmes masave penale dhe civile;

4. *U bën thirrje* qeverive, komunitetit ndërkombëtar dhe të gjitha organizatave të tjera që merren me konfliktin dhe pas-konfliktin dhe situata të tjera emergjence për të trajtuar rrezikshmërinë e madhe që gratë dhe vajzat të trafikohen dhe të shfrytëzohen, dhe dhunën me bazë gjinore;

5. *U kërkon* qeverive që të krijojnë, zbatojnë dhe forcojnë masa efektive, me ndjeshmëri gjinore dhe moshore për të luftuar dhe eliminuar të gjitha format e trafikimit të grave dhe vajzave, përfshirë shfrytëzimin ekonomik dhe seksual, si pjesë e një strategjie kundër trafikimit që integron perspektivën e të drejtave të njeriut, dhe të hartojë plane kombëtare veprimi në lidhje me këtë;

6. *U kërkon* qeverive, në bashkëpunim me organizatat ndërqeveritare dhe jo-qeveritare, të mbështesin dhe të caktojnë burime për të forcuar masat parandaluese në veçanti edukimin e grave dhe të burrave, si dhe të vajzave dhe djemve, për barazinë gjinore, vetë-respektimin dhe respektin reciprok dhe të ndërmarrë fushata në bashkëpunim me shoqërinë civile, për të rritur ndërgjegjësimin publik në nivel kombëtar dhe komunitar;

7. *Inkurajon* qeveritë që të marrin masat e përshtatshme për zhdukjen e kërkesës për turizëm seksual, veçanërisht të fëmijëve, përmes të gjitha masave të mundshme parandaluese;

8. *U kërkohet* qeverive që të zhvillojnë programe dhe politika edukative dhe trajnimi dhe të shohin mundësinë për të hartuar dhe vënë në fuqi legjislacion që synon parandalimin e turizmit seksual, duke i vënë theks të veçantë mbrojtjes së të rejave dhe fëmijëve;

9. *Gjithashtu u kërkohet* qeverive që të marrin në konsideratë nënshkrimin dhe ratifikimin dhe shteteve palë të zbatojnë instrumentet ligjorë të Kombeve të Bashkuara, si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional, Konventën për Zhdukjen e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave dhe Protokolli Opsional i saj, si dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe Protokolli Opsional i saj për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve, si dhe Konventa për Punën e Detyruar 1930 (Konventa nr. 29), Konventa për Diskriminimin në lidhje me Punësimin dhe Profesionin, 1958 (Konventa Nr. 111) dhe Konventa për Ndalimin dhe Veprimin e Menjëherëshëm për Zhdukjen e Formave më të këqija të Punës së të miturve, 1999 (Konventa Nr. 182), e Organizatës Ndërkombëtare të Punës;

10. *Inkurajohen* shtetet anëtare që të forcojnë programet kombëtare dhe të përfshihen në bashkëpunimin dypalësh, nënrajonar, rajonal dhe ndërkombëtar përfshirë edhe nismat rajonale ose planet e veprimit<sup>12</sup> për trajtimin e problemit të trafikimit të personave, përmes shkëmbimit të informacionit, mbledhjes së të dhënave për gjininë dhe moshën dhe teknika të tjera, ndihma ligjore reciproke, si dhe lufta kundër korrupsionit, pastrimit të parave që burojnë nga trafikimi, përfshirë për qëllime të shfrytëzimit seksual, dhe garantimi që këto marrëveshje dhe nisma u përgjigjen problemit të trafikimit që ndikon gratë dhe vajzat;

11. *U bën thirrje* qeverive që të kriminalizojnë të gjitha format e trafikimit të personave, duke pranuar tendencën në rritje të trafikimit për qëllime të shfrytëzimit seksual, shfrytëzimit seksual tregtar, abuzimi, turizmi për seks, puna e detyruar dhe sjellja përpara drejtësisë dhe ndëshkimi i të gjithë keqbërësve dhe ndërmjetësve të përfshirë, qofshin vendas ose të huaj, përmes autoriteteve vendore kombëtare, ose në vendin e origjinës ku ndodh abuzimi, sipas një procesi të ligjshëm, si dhe ndëshkimi i personave me autoritet që janë fajtor për ngacmimin seksual të viktimave të trafikut që janë nën ruajtjen e tyre;

12. *U bën thirrje* qeverive që të marrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar që viktimat e trafikimit të mos dënohen për shkak se janë trafikuar dhe të mos riviktimizohen si rezultat i veprimeve të marra nga autoritetet qeveritare, dhe inkurajon qeveritë që të parandalojë, brenda legjislacionit të tyre dhe në përputhje me politikat kombëtare, që viktimat e trafikimit të mos ndiqen penalisht për hyrjen ose qëndrimin, e tyre ilegal;

---

<sup>12</sup> Si psh Procesi i Balit për Kontrabandën e Njerëzve, Trafikimin e Personave dhe Krime të tjera, Transnacionale, Nisma e Koordinuar Ministeriale Mekong kundër Trafikimit, Plani i Veprimit për rajonin e Azisë dhe të Pacifikut, të Nismës Rajonale Aziatike kundër Trafikimit në Persona, veçanërisht Gra dhe fëmijë (shih A/C.3/55/3, aneksi), iniciativat e Bashkimit Evropian për një Politikë dhe programe Evropiane për trafikimin e qenieve njerëzore, si shprehet së fundi në planin e BE për praktikatat më të mira, standardet dhe procedurat për luftën dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, adoptuar në dhjetor 2005, aktivitetet e Këshillit të Evropës dhe të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Shoqata e Azisë Jugore për Konventën e Bashkëpunimit Rajonal për Parandalimin e Trafikimit të Grave dhe të Fëmijëve për Prostitucion, Organizimi i Takimit të Autoriteteve Kombëtare të Shteteve Amerikane për Trafikimin e Personave dhe aktivitetet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe Organizata Ndërkombëtare për Migrimin në këtë fushë.

13. *i fton* qeveritë që të marrin në konsideratë krijimin e një mekanizmi kombëtar për koordinimin, për shembull, të një raportuesi kombëtar, ose një organi të përbërë nga anatarë nga disa agjenci, me pjesëmarrjen e shoqërisë civile, përfshirë organizatat jo-qeveritare. Ky mekanizëm të inkurajojë shkëmbimin e informacionit dhe të raportojë të dhënat, shkaqet, faktorët dhe tendencat e dhunës kundër grave, në veçanti të trafikimit, dhe të përfshijë të dhënat e zbërthyer sipas seksit dhe moshës;

14. *Inkurajon* qeveritë dhe organet përkatëse të Kombeve të Bashkuara, brenda burimeve ekzistuese, të marrin masat e përshtatshme për të rritur ndërgjegjësimin public mbi trafikimin e personave, veçanërisht të grave dhe të vajzave; të shkurajojë deri në zhdukje kërkesën që mban gjallë format e shfrytëzimit, përfshirë shfrytëzimin seksual dhe punën e detyruar; të publikojnë ligjet, rregulloret dhe dënimet që lidhen me këto vepra; të theksohet se trafikimi është një krim i rëndë;

15. *U bën thirrje* qeverive përkatëse që të caktojnë burime, për programet e gjithanshme për shërimin fizik, psikologjik dhe social të viktimave të trafikut, përfshirë përmes trajnimit për punë, ndihmës ligjore me një gjuhë që ato mund ta kuptojnë, dhe kujdesit shëndetësor përfshirë HIV/AIDS, dhe marrja e masave për të bashkëpunuar me organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare dhe të ofrohet kujdes social, mjekësor dhe psikologjik për viktimat;

16. *Inkurajon* qeveritë që në bashkëpunim me organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare, të ndërmarrin ose të forcojnë fushatat që synojnë qartësimin e shanseve, kufizimeve dhe të drejtave në rast të migrimit si dhe informacioni për rreziqet e migracionit të parregullt dhe rrugët dhe mënyrat e përdorura nga trafikuesit, për t'i ndihmuar gratë që të marrin vendime të informuara dhe të mos bëhen viktima të trafikimit;

17. *Inkurajon* qeveritë që të intensifikojnë bashkëpunimin me organizatat joqeveritare për të zhvilluar dhe zbatuar programe me ndjeshmëri gjinore dhe moshore, këshillim efektiv, trajnim dhe ri-integrim në shoqëri të viktimave të trafikimit dhe programe që ofrojnë strehë dhe ndhmë për viktimat;

18. *U kërkon* qeverive që të ofrojnë trajnime për zyrtarët e agjencive të zbatimit të ligjit, imigracionit, dhe zyrtarë të tjerë në parandalimin e luftën kundër trafikimit të personave, përfshirë shfrytëzimin seksual të grave dhe vajzave, dhe në lidhje me këtë kërkon nga qeveritë, veçanërisht punonjësit e zbatimit të ligjit, zyrtarët e imigracionit, zyrtarët e zyrave konsullore, punonjësit socialë dhe zyrtarë të tjerë që janë në vijën e parë, që të garantojnë trajtimin e viktimave të trafikimit, në respekt të plotë për të drejtat e njeriut të këtyre viktimave dhe me ndjeshmëri gjinore dhe moshore, dhe të garantojë parimet e mos-diskriminimit, përfshirë ndalimin e diskriminimit racial;

19. *Fton* qeveritë që të marrin hapa për të garantuar që procedurat e drejtësisë penale dhe programet për mbrojtjen e dëshmitarëve të jenë të ndjeshme ndaj situatës së veçantë të grave dhe vajzave të trafikuar dhe që viktimat e trafikut të mbështetn gjatë kryerjes së ankesave në polici dhe tek autoritetet e tjera, pa frikë dhe të jenë të gatshme sa herë që thirren për t'u paraqitur përpara sistemit të drejtësisë, dhe të garantohet që gjatë kësaj kohe ato të kenë qasje

në mbrojtjen me ndjeshmëri gjinore dhe moshore, dhe në ndihmën ligjore, sociale, mjekësore, dhe ligjore, përfshirë mundësinë për t'u kompensuar nga dëmet e vuajtura;

20. Qeveritë ftohen edhe për të mbështetur median, përfshirë internet provider, që të adoptojnë ose forcojnë masa vetë-rregulluese për të nxitur përdorimin me përgjegjësi të medias, veçanërisht të internetit, me qëllim eliminimin e shfrytëzimit të grave dhe të fëmijëve, në veçanti të grave dhe të vajzave që mund të çojë në trafikim;

21. Fton sektorin fitimprurës, në veçanti turizmin dhe telekomunikacionin, përfshirë organizatat e medias, që të bashkëveprojnë me qeveritë për eliminimin e trafikimit të grave dhe të fëmijëve, në veçanti të vajzave përmes shpërndarjes së informacionit në lidhje me rreziqet e trafikimit, të drejtat e personave të trafikuar dhe shërbimet në dispozicion të viktimave të trafikimit;

22. Thekson nevojën për mbledhje sistematike të të dhënave të zberthysa sipas moshës dhe seksit, të studimeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për të mundësuar nxjerrjen e shifrave të krahasueshme

Dhe kërkon nga qeveritë që të rrisin shkëmbimin e informacionit dhe mbledhjen e të dhënave si rrugë për të nxitur bashkëpunimin për të luftuar trafikimin;

23. Fton qeveritë, organet e Kombeve të Bashkuara, agjencitë dhe mekanizmat special, organizatat ndërqeveritare dhe jo qeveritare dhe sektorin privat që të bashkëpunojnë dhe të kryejnë studime dhe kërkime të përbashkëta mbi trafikimin e grave dhe të vajzave që mund të shërbejnë si bazë për politikat dhe ndryshimet.

24. Fton qeveritë që me mbështetjen e Kombeve të Bashkuara, të organizatave të tjera ndërkombëtare, duke marrë parasysh praktikat më të mira, të formulojnë manual trajnimi dhe materiale informuese dhe të trajnojnë oficerët e zbatimit të ligjit, të gjyqësorit personelin mjekësor dhe ndihmës, me qëllim ndjeshmërinë për nevojat e posaçme të grave dhe të vajzave viktimave;

25. Inkurajon qeveritë, agjencitë e tjera ndërqeveritare, dhe organizatat ndërkombëtare që të garantojnë që personeli ushtarak, paqeruajtës dhe ushtarak i dërguar në vende në konflikt, pas konfliktit dhe në situata urgjence, të trajnohet për sjelljen që nuk nxit, lehtëson apo shfrytëzon trafikimin e grave dhe të vajzave, përfshirë shfrytëzimin seksual dhe të rritet ndërgjegjësimi i këtij personeli për rrezikun e mundshëm që u kanoset viktimave të konfliktit dhe situatave të tjera urgjente, përfshirë fatkeqësitë e natyrës, për t'u trafikuar;

26. Fton Shtetet palë të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, dhe Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut<sup>13</sup> që të përfshijnë informacion dhe statistika për trafikimin e grave dhe të vajzave si pjesë e raporteve të tyre kombëtare për komitetet respektive dhe për të punuar për zhvillimin e metodologjisë së përbashkët dhe statistikore për të fituar të dhënat të krahasueshme;

---

<sup>13</sup> Rezoluta 2200 A (XXI), aneks

27. *Kërkon* nga Sekretari i Përgjithshëm që t'i dorëzojë Asamblesë së Përgjithshme në sesionin e vet të gjashtëdhjetë e pestë një raport që përmbledh ndërhyrjet dhe strategjitë e suksesshme, si dhe hendeqet në trajtimin e dimensioneve gjinore të problemit të trafikimit në persona, dhe ofron rekomandime për forcimin e taktikës me orientim gjinore dhe moshor brenda aspekteve të ndryshme të përpjekjeve për të trajtuar trafikimin e personave.

